

Z. Admir Malaj ka lindur në qytetin e Vlorës, më datë 06 Mars 1983.

Në vitin 2001-2005 është pajisur me Diplomë të Nivelit të Parë, në Fakultetin e Ekonomisë, Dega Menaxhim Turizmi pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë. Gjatë viteve 2005-2009 ka filluar studimet në Albanian University Tiranë, në Fakultetin e Drejtësisë, ku është pajisur me titullin “Jurist”.

Z. Malaj ka punuar në sektorin privat gjatë periudhës 2010-2011 si agjent doganor dhe gjatë vitit 2011 si menaxher pranë Degës “Western Union Vlorë”. Në vitin 2013 fillon karrierën e tij në sektorin publik si përgjegjës borxhi pranë Drejtorisë së Tatim Taksave, Bashkia Vlorë. Në vitin 2016 është emëruar Drejtor pranë Drejtorisë së Portit Vlorë.

Prej vitit 2022, Z. Malaj, drejton Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Vlorë.